



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LEZHE**

## **STUDIMI GJEOLGJIK**

**Objekti: "RIKONSTRUKSION I KANALIT UJITES DEGA KRYESORE KOTERR - KAKARRIQ,  
BASHKIA LEZHË".**

**Projektues:**

**B.O.E "SIRE-ALB" SHPK & "ENGINEERING CONSULTING GROUP" sh.p.k.**

**2024**

## **1-HYRJE.**

Ne kete raport do te paraqitet vlerësimi i rezultateve te studimit gjeologo-inxhinerik te sheshit te ndertimit per punimet rehabilituese, ne kanalet ujtese kryesore pergjate Lezhes, perkatesisht ne keto zona me degezime dhe gjatesi si me poshte:

Dega kryesore Koterr – Kakarriq veshje e re 5.075 km.

Qellimi i studimit te kryer ka qene:

- Njohja e ndertimit gjeologo-litologjik te sheshit.
- Vetite fiziko-mekanike te dherave te ndara ne shtresa, per te gjithë prerjen, nga siperfaqeja e tokes natyrale deri ne thellesine 6.0 m.

Ky studim ti sherbeje projekt-zbatimit, per rikonstrukcionin dhe sistemimin e deges ujtese te kanalit Koterr - Kakarriq. Keto punime do te konsistojne ne pastrime, germime, mbushje, veshje me beton per kanaliin. Per realizimin e ketij studimi ne jemi mbeshtetur tek:

1-Studimi i materialeve arshivale te studimeve te meparshme gjeologo-inxhinerike, te kryera ne afersi te sheshit te ndertimit, nga autore te tjere te ketij specialiteti.

2-Vrojtime siperfaqesore te fenomeneve fiziko-gjeologjike si brenda sheshit te ndertimit ashtu dhe per rreth tij.

## **2-Pozicioni dhe ndertimi gjeologjik i sheshit.**

Sheshi i ndertimit ndodhet ne qytetin e Lezhes, ne nje distance rreth 1 5km ne veri te qytetit te Lezhes. Persa i perket ndertimit gjeologjik sheshi ka nje ndertim te thjeshte. Depozitimet me te vjetra jane Cr<sub>2</sub> +Pg<sub>1-2</sub> te perbere nga flishi alevrolito-ranoro-mergelore dhe gelqerore, qe ne sheshin e studiuar nuk kane dalje ne siperfaqe. Mbi keto depozitime jane te vendosura depozitimet e kuaternarit, me origjine detare dhe aluviale te lumit.

### 3-Kushtet gjeologo-inxhinerike te sheshit te ndertimit.

Si bazament per objektin e propozuar per rikonstrukcion, do te sherbejne depozitimet e aluviale te kuaternarit.

Duke u mbeshtetur ne te dhenat e studimeve gjeologo-inxhinerike te kryera nder vite ne afersi te sheshit te ndertimit, kemi vecuar dy shtresa, me veti fiziko-mekanike te ndryshme.

Me poshte ne menyre te detajuar po japim cdo shtrese, pershkrimin litologjik dhe vetite fiziko-mekanike.

**(Shtresa-1)** Perfaqesohet nga depozitimet aluviale te kuaternarit dhe perbehet nga suargjila te lehta deri ne surane e rende, pluhurore, me ngjyre kafe, me lageshti, plastike deri plastike te buta, pak deri mesatarishte te ngjeshura. Kjo shtrese gjendet ne thellesine 5.0 m nga sipërfaqeja e tokes natyrale.

Vetit fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike.

Fraksioni ranor.....	28.6%
Fraksioni pluhuror .....	61.5%
Fraksioni argjilor .....	9.9%
Lageshtia natyrale .....	26.1%
Kufiri i siperm i plasticiteti.....	27.0%
Kufiri i siperm i poshtem .....	20.4%
Numri i plasticitetit.....	6.6
Pesha vellimore .....	1.89gr/cm <sup>3</sup>
Pesha e skeletit.....	1.49gr/cm <sup>3</sup>
Pesha specifike .....	2.70gr/cm <sup>3</sup>
Moduli i kompresionit .....	60.7kg/cm <sup>2</sup>
Kendi i ferkimit te brendshem.....	18 <sup>0</sup>
Ngarkesa e lejuar.....	1.6 kg/cm <sup>2</sup>
CBR .....	6-8%

**(Shtresa-2)** Perfaqesohet nga depozitimet detare te kuaternarit te perbera nga Surere e lehte me breza te holle suargjilash, me ngjyre bezhe, me lageshti, me plasticitet te dobet, pak deri mesatarisht te ngjeshura.

Vetite fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike.

Fraksioni ranor.....	36.7%
Fraksioni pluhuror .....	57.0%
Fraksioni argjilor .....	6.3%
Lageshtia natyrale .....	26.1%
Kufiri i siperm i plasticiteti .....	28.0%
Kufiri i siperm i poshtem .....	20.4%
Numri i plasticitetit.....	7.6
Pesha vellimore .....	1.86gr/cm <sup>3</sup>
Pesha e skeletit.....	1.49gr/cm <sup>3</sup>
Pesha specifike .....	2.70gr/cm <sup>3</sup>
Moduli i kompresionit .....	60.7kg/cm <sup>2</sup>
Kendi i ferkimit te brendshem.....	18 <sup>0</sup>
Ngarkesa e lejuar.....	1.5 kg/cm <sup>2</sup>

**Punoi:**

**B.O.E "SIRE-ALB" SHPK & "ENGINEERING CONSULTING GROUP" sh.p.k.**